



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:185531

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06097783

P.nr.209/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, DEGA NË VUSHTRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.B., nga ... Republika e Serbisë tani me banim ne fshatin ... komuna e Gjilanit, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Xhelal Hasani dhe te pandehurit D.I. nga Gjilani te cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Kushtrim Salihu, për shkak te veprës penale Zjarrvënja nga neni 322 par. 2 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit i Përgjithshëm PP-II-nr.1097/2024 të datës 19.08.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 23.08.2024 po te njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 28.08.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

1.F.B., nga babai Q... dhe nëna S..., mbiemri i vajzërisë së nënës Z..., i lindur me datë ... në ..., Serbi, me vendbanim të përkohshëm në Fshatin ..., komuna e Gjilanit, (...), shqiptar, shtetas i Republikës së Serbisë, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të mesme ekonomike, i martuar, prind i një fëmiu, me numër personal ..., dhe

2.D.I., nga babai A... dhe nëna M..., mbiemri i vajzërisë së nënës K..., i lindur me datë ... në Gjilan, ku edhe jeton në ..., rruga ..., pn, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion bukëpjekës dhe moler, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të dobët ekonomike, i pa martuar, me numër personal ...

JANË FAJTORË

SEPSE: Me datë 12.05.2024 rreth orës 03.47h, në rrugën ... në Vushtrri, saktësisht mbrapa parkingut të objektit banesor ku jetojnë të dëmtuarit D.S. dhe B.S.M., të pandehurit në bashkëkryerje dhe me dashje kanë ndezur zjarrin me qëllim të dëmtimit apo asgjësimit të veturës pronë e të dëmtuarit D.S., në atë mënyrë që me veturën e markës Mercedes Benz, me ngjyrë hiri, me tabela regjistrimi ..., të cilën e drejton i pandehuri F.B., nisen nga qytetit i Gjilanit në orët e

vona të natës dhe shkojnë në qytetin e Vushtrrisë, ofrohen tek vetura e të dëmtuarit D..., e markës BMW, ngjyrë e zezë, me tabela regjistrimi ..., të cilës i pandehuri D.I. ia vë flakën duke hedhur derivate të benzinës në pjesën e përparme të veturës dhe më pas që të dy largohen me vrap në drejtim të veturës së tyre të cilën e kishin parkuar paraprakisht në rrugën ..., përkatësisht në rrugicën ..., duke u larguar më pas në drejtim të qytetit të Gjilanit, ndërsa si pasojë e zjarrit, të dëmtuarit D.S. i është shkaktuar dëm material në vlerë prej 18.000€ (tetëmbëdhjetëmijë euro), përderisa të dëmtuarës B.S.M. i është dëmtuar vetura e markës Ford C-Max, ngjyrë e bardhë, ku vlera e dëmit sipas vlerësimit të saj, kap shumën prej rreth 1700€ (njëmijeshtatëqind euro),

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Zjarrvënia nga neni 322 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 42, 69,70 si dhe nenin 322 par.2 te KPRK-se si dhe neni 364, 452 dhe nenit 462 te KPPK-së Gjykata iu shqipton:

DËNIM ME BURG

Me të cilin të akuzuarit F.B. i shqipton dënimin me burgim prej një vit e gjashtë muaj, i cili dënim do te ekzekutohet, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar ne paraburgim nga data 01.07.2024 e tutje, do ti llogaritet ne dënimin shqiptuar.

Me të cilin të akuzuarit D.I. i shqipton dënimin me burgim prej një vit e gjashtë muaj, i cili dënim do te ekzekutohet, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar ne paraburgim nga data 24.07.2024 e tutje, te pandehurit do ti llogaritet ne dënimin shqiptuar.

OBLIGOHEN te pandehurit qe secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 30€, ne emër te kompensimit te viktimave te krimit shumen prej nga 20€, si dhe secili veç e veç shumën prej 60€, në emër të transportit.

I dëmtuari i parë D.S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Detyrohen te pandehurit qe solidarisht të ia kompensojnë demin në lartësi prej 2050€ (dymijepesëdhjetë euro), te dëmtuarës B.S.M..

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP-II-nr.1097/2024 të datës 19.08.2024, kundër të pandehurit F.B., nga ... Republika e Serbisë tani me

banim ne fshatin ... komuna e Gjilanit, dhe te pandehurit D.I. nga Gjilani, për shkak te veprës penale Zjarrvënja nga neni 322 par. 2 te KPRK-së, e lidhur me nenin 31 te KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 23.08.2024 ku në këtë seancë të shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykues i ka njoftuar te pandehurit me të drejtat e tyre në këtë çështje penale. Te pandehurve iu është lexuar aktakuza PP-II-nr.1097/2024 të datës 19.08.2024 nga ana e prokurorit te shtetit dhe të njëjtit janë deklaruar se e kuptojnë ne tërësi aktakuzën. Ne kuptim te dispozitave te nenit 241 te KPP-së, pasi qe gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të akuzuarve iu është dhënë mundësia të pranojnë ose të mos e pranojnë fajësinë sipas aktakuzës.

Lidhur me fajësinë në shqyrtimin fillestar, i pandehuri i parë F.B., pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovice, dhe ka shtuar se i vjen keq për palën e dëmtuar për atë që ka ndodh, nuk kemi pasur kurgjo me ta, nuk kemi pasur ndonjë qëllim të keq, por kemi qenë në ndikim të drogës, i kërkoj falje palëve të dëmtuara, betohem se nuk do ta përsëris prapë këtë vepër penale. Ka shtuar se është në gjendje që të marrë përsipër kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarve, për pjesën që i takon. I pandehuri i parë F.B., lidhur me kërkesën e të dëmtuarës së dytë B.S.M., ka deklaruar se jam në gjendje të ia kompensojë pjesën e dëmit aq sa është vlerësuar nga mjeshtri i automjeteve, gjegjësisht pjesën e shumës prej 2.050 euro.

I pandehuri dytë D.I. pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij ka deklaruar se don ta pranoj fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar se e ndjej veten tejet fajtorë, sa i përket ditës kritike i pandehuri F... ka qenë vetëm shofer, ndërsa aktin e kam kryer unë, jam në gjendje që të ia kompensojë dëmin palëve të dëmtuara, ndjehem i penduar për atë që kam bërë dhe i kërkoj falje prapë palëve të dëmtuara si dhe premtoj se më kurrë nuk do të bie ndesh me ligjin. Sa i përket natës kritike kemi qenë në ndikim të narkotikëve dhe nuk kemi qenë vetvetja, por që gjithsesi ndjehem i penduar për atë që kam bërë. I pandehuri i dytë D.I., lidhur me kërkesën e të dëmtuarës së dytë B.S.M., ka deklaruar se jam në gjendje të ia kompensojë pjesën e dëmit aq sa është vlerësuar nga mjeshtri i automjeteve, gjegjësisht pjesën e shumës prej 2.050 euro.

Pas pranimit të fajësisë, gjykata iu ka tërhequr vërejtjen të pandehurve lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtit i ka njoftuar për dënimet e parapara, se nuk do të mund të kundërshtojë provat apo të parashtrij prova në këtë çështje penale, se nuk mund ta atakojnë vendimin e gjykatës për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por mund ta atakojnë për shkak të lartësisë së dënimit dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë, gjykata detyrimisht do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese, gjykata paraprakisht i ka njoftuar te pandehurit rreth benefiteve lidhur me pranimin e fajësisë.

I pandehuri i parë F.B. në shqyrtimin fillestar edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se e ndien vetën fajtor.

I pandehuri i dytë D.I. në shqyrtimin fillestar edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se e ndien vetën fajtor.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, meqë pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre, pranimi ka mbështetet në fakte të çështjes që përmban aktakuza si dhe në provat materiale të cilat i janë bashkëngjitur shkresave të lëndës. Andaj i propozojë gjykatës që të njëjtit ti shpallë fajtorë për veprën e kryer penale, të iu shqiptojë sanksion penale me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese shkallën e lartë të dashjes, pra shkalla e përgjegjësisë penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, pasi të pandehurit me dashje dhe me përgatitje paraprake nisen nga qyteti i Gjilanit, për në qytetin e Vushtrrisë, dhe gjatë rrugës furnizohen me derivate të benzinës, pastaj edhe kryejnë veprën penale me c'rast shkaktojnë edhe dëme, po ashtu të ketë parasysh edhe sjelljen e mëparshme të kryesve, posaçërisht të të pandehurit D.I., i cili nga ekstrakti i të dhënave penale të siguruar nga KGJK rezulton të jetë i dënuar me gjithsej 24 aktgjykime të formës së prerë, për vepra të natyrave të ndryshme penale. Edhe me tej mbetemi pranë propozimit që të pandehurve tu vazhdohet masa e paraburgimit, meqë konsiderojmë se ende ekzistojnë kushtet dhe rrethanat për të cilat edhe është kërkuar vazhdimi i masës së paraburgimit.

I dëmtuari D.S. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana të pandehurve ka deklaruar se paraqet kërkesë pasurore juridike, dhe edhe më tutje vazhdon të dëmtohet, pasi që më duhet vazhdimisht të huazojë veturë me pagesë, kam grua, fëmijë, prindër të vjetër dhe veturën nuk e kam paguar ende tërësisht, dhe ia kam borxh ende shitësit një shumë të parave, e dyta këta persona nuk po i njoh, i dëgjova që thanë se kanë qenë në ndikim të narkotikeve, por nuk besoj që kjo qëndron, pasi që të vijnë nga Gjilani në adresën time, nën ndikimin e narkotikëve është e çuditshme, që nga ajo ditë ndihem i kërcënuar dhe kam frikë se më ndodh diçka, sepse askush nuk e beson se vetura është djegur për qejf, dhe kërkoj që dëmi të më kompensohet sa më parë. Nuk pajtohem që të më paguajnë vetëm 18.000 euro, pasi që jam dëmtuar më shumë dhe vazhdoj të dëmtohem.

E dëmtuara B.S.M. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana të pandehurve ka deklaruar se paraqet kërkesë pasurore juridike dhe dëmi është 2.050 euro, pasi që kështu është vlerësuar nga mjeshtri "...". Unë vazhdoj të ndjehem e shqetësuar nga rasti që ka ndodhur dhe ende jam e stresuar, veturën e kemi marrë nga Gjermani para një viti dhe të njëjtën nuk e kemi paguar ende.

Mbrojtësi i të pandehurit F.B. av. Xhelal Hasani në fjalën e tij lidhur me pranimin e fajësisë se të pandehurit ka deklaruar I propozojë gjykatës që konform dispozitave ligjore të merr aktvendim mbi pranimin e fajësisë, konsiderojë se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vetëdijshme, vullnetare dhe i njëjti mbështetet edhe në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës. Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozojë gjykatës që si rrethanë veçanërisht lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, moshën e re, faktin se i pandehuri është baba i një fëmije të mitur, bashkëpunimin e të pandehurit me organet e drejtësisë për zbardhjen e këtij rasti, keqardhjen e shprehur, kërkim faljen e të njëjtit ndaj palës së dëmtuar, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale, si dhe të merr parasysh se i pandehuri më parë nuk

ka qenë i gjykuar dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë penale. I mbrojturi im është i gatshëm që të ia kompensojë dëmit të dëmtuarve.

Mbrojtësi i te pandehurit D.I. av. Kushtrim Salihu lidhur me pranimin e fajësisë te te pandehurit ka deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim, i njëjti e pranon fajësinë për veprën penale, për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës duke shprehur keqardhje për këtë veprë, andaj i propozojmë gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë, pasi që gjen mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, i propozojmë gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, të merr si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri, me çka gjykatës i ndihmojë në vërtetimin e gjendjes faktike në mënyrë të shkurtër, duke mos i krijuar shpenzime procedurale, gjithashtu të vlerëson si rrethanë lehtësuese edhe keqardhjen e shfaqur në këtë gjykatë për palët e dëmtuara, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen do të këtë kujdes dhe nuk do të bie ndesh me ligjin, është baba i një fëmije, moshën e re të te pandehurit dhe rrethanat tjera të cilat i gjen gjykata sipas detyrës zyrtare dhe ti shqiptojë një dënim sa më të butë me çka do të arrihet edhe qëllimi i dënimit për këtë veprë, s ai përket masës së paraburgimit i propozojmë gjykatës që masa e paraburgimit të ndërpritet ndaj te pandehurit, pasi që tani kanë pushuar të gjitha kushtet ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Gjykata pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 242 par 1 të KPP-së dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës si dhe ka pranuar deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga te pandehurit sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale te cilat gjinden ne shkresat e lendes dhe atë, procesverbali i marrjes ne pyetje te te pandehurit D.I. ne prokurori dt. 06.08.2024; procesverbali i marrjes ne pyetje te te dëmtuarit D.S. ne prokurori dt. 25.07.2024; procesverbali i marrjes ne pyetje te te pandehurit F.B. ne prokurori dt. 24.07.2024; procesverbali i marrjes ne pyetje te te dëmtuares B.S.M. ne prokurori dt. 24.07.2024; dy CD me nr. te rastit 2024-BD-434; procesverbali i marrjes ne pyetje te te dëmtuarit D.S. ne polici dt. 07.08.2024; procesverbali i marrjes ne pyetje te te dëmtuarit D.S. ne polici dt. 12.05.2024; procesverbali i marrjes ne pyetje te te dëmtuares B.S.M. ne polici dt. 12.05.2024; procesverbali i marrjes ne pyetje te te dëmtuarit D.S. ne polici dt. 23.05.2024; procesverbali i marrjes ne pyetje ne polici te te pandehurit F.B. dt. 01.07.2024 ; raporti i oficerit dt. 12.05.2024; shënimi zyrtar i hetuesit dt. 12.05.2024; raporti mbi hulumtimin e shkaqeve te zjarrit nga grupi hetimor punues; raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes nga njësia e forenzikes dt. 12.05.2024; fotodokumentacioniu ne shtat shtojca; informacionet e personit për te pandehurin D.I. dhe per te pandehurin F.B., si dhe shkresat e tjera te lendes.

Të gjitha këto prova duke konsideruar edhe pohimin e vet te pandehurve, vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e kanë kryer te pandehurit, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklarinimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për te pandehurin e parë F.B., Gjykata ne vështrim te dispozitave te nenit 69 e 70 te KPRK-së ka marrë parasysh por pa u kufizuar ne

rrethanat lehtësuese dhe renduese ne vijim ku si rrethanë lehtësuese, për te pandehurin e parë gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, bashkëpunimin vullnetar te te pandehurit te parë ne te gjitha fazat e kësaj procedure, keqardhjen e shfaqur, sjelljen e te pandehurit pas kryerjes se veprës penale ku i njëjti ka kërkuar falje dhe ka shprehur gatishmëri qe ti kompensoj te dëmtuarit ne pjesën e demit qe i takon. Sa i përket rrethanave renduese gjykata konsideroj, shkallen e lartë te dashjes se te pandehurit te parë, motivet e ulëta për kryerjen e kësaj vepre penale intensitetin e rrezikimit te vlerës se mbrojtur ku gjykata ka vlerësuar jo vetëm demin material por edhe ate moral duke pas parasysh se te dëmtuarit kane shprehur shkalle te larte te shqetësimit për demin qe iu ishte shkaktuar.

Sa i përket te pandehurit te dytë D.I., ne vështrim te dispozitave te nenit 69 e 70 te KPRK-së ka marrë parasysh por pa u kufizuar ne rrethanat lehtësuese dhe renduese ne vijim ku si rrethanë lehtësuese, për te pandehurin e dytë gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, rrethanat personale te te pandehurit te dytë, bashkëpunimin vullnetar te te pandehurit te dytë ne te gjitha fazat e kësaj procedure, keqardhjen e shfaqur, sjelljen e te pandehurit të dytë pas kryerjes se veprës penale ku i njëjti ka kërkuar falje nga te demtuarit, dhe ka shpreh gatishmëri qe ti kompensoi te demtuarit. Sa i përket rrethanave renduese gjykata konsideroj, shkallen e lartë te dashjes se te pandehurit te dytë, motivet e ulëta për kryerjen e kësaj vepre penale intensitetin e rrezikimit te vlerës se mbrojtur ku gjykata ka vlerësuar jo vetëm demin material por edhe atë moral duke pas parasysh se te dëmtuarit kane shprehur shkalle te larte te shqetësimit për demin qe iu ishte shkaktuar si dhe faktin se i pandehuri i dyte ka qenë edhe me parë i dënuar për vepra te ndryshme penale çka del si tregues i nevojës se riedukimit imediat te te njëjtit.

Në nenin 322, par.1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Zjarrvenia e kryen: “Kushdo që ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit të pasurisë së personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.”

Kurse si formë e kualifikuar e kësaj vepre penale është dispozita e nenit 322 par 2 lidhur me nenin 31 te KPRK-së për te cilën edhe janë akuzuar te pandehurit e kryen “ Kushdo që ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit apo asgjësimit të banesës së banuar ose veturës në shfrytëzim nga personi tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet” e qe ne rastin konkret ne veprimet e te pandehurve, nga qe te dytë është kryer pikërisht kjo formë e kualifikuar e veprës penale.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar me burgim me te cilin te pandehurit te parë i është shqiptuar dënimi me burgim prej një vit e gjashtë muaj i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi ,dhe për te pandehurin e dytë dënimi me burg me te cilin te pandehurit te dytë i është shqiptuar dënimi me burgim prej një vit e gjashtë muaj i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale te te pandehurve dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se nuk ka pasur vend qe gjykata te shqiptoj dënim me te ashpër apo me te butë.

Gjykata vlerëson se dënimi me burgim për qe te dy te pandehurit ne rastin konkret është i domosdoshëm në mënyre qe ndaj te pandehurve te arrihet qëllimi i dënimit si ne dispozitat e nenit 38 te KPRK-së dhe atë qe të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale qe kanë kryer, dhe te ndikoj ne ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Së këndejmi me pranimin e gjitha këtyre rrethanave, nuk ka pasur vend që të pandehurve të iu shqiptohen dënim më i rëndë apo më i bute.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ne vështrim te dispozitave te nenit 462 te KPP-së, ka detyruar te pandehurit qe te dëmtuarës B.S.M., solidarisht te ja kompensojnë demin e shkaktuar, pasi qe e dëmtuara i ka dorëzuar gjykatës te dhëna qe paraqesin bazë te sigurt për vendosje lidhur me kërkesën pasurore juridike dhe për faktin se te pandehurit nuk e kane kontestuar lartësinë e kërkesës se te dëmtuarës se dytë. Ndërsa duke qen se i dëmtuari i parë ka pasur kërkesa te pa përcaktuara ashtu qe përpos demit kryesor ka kërkuar kompensim demi edhe mbi baza te tjera por pa arritur qe te argumentoj lartësinë e kërkesës pasurore juridike. Neni 462 par 2 i KPP-së ka paraparë se “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.” Rrjedhimisht gjykata ne zbatim te dispozitës si me sipër, sa i perket kërkesës pasurore ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat e bazuara në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.209/24, datë: 28.08.2024

Zyrtarja Ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

Numri i lëndës: 2024:185531
Datë: 28.08.2024
Numri i dokumentit: 06097783

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.